



Tuberkulozin është me rëndësi ta sherosh

Cka është tuberkulozi? Tuberkulozi është një smundje serioze ngjitesë dhe shkaktohet nga bakteria M. Tuberculosis. Smundja mund ti përfshij të gjitha organet e trupit, por më së shpeshi mushkërit. Me sherim të hershem dhe të duhur tuberkulozi mund të sherohet. Sherimi i tillë në Norvegji është falas.

Si ngjitet tuberkulozi? Tuberkulozi ngjitet përmes ajërit. Vetëm përonat ne tuberkuloz në mushkëri mund tua ngjitin tjerve. Disa kanë tuberkulozin në mushkëri pa e ndir veten të smuar. Por ata mund tua ngjitin të tjerve.

Kur personat me tuberkuloz në mushkëri kolliten, teshin apo flasin bakterjet shpërndahen në ajër. Personat tjer mund ti thithin ato bakterie. Tuberkulozi zakonisht shpërndahet te personat që jetojn shumë afër njëritjetrit.

Zhvillimi i smundjes Mund të kalojn shumë vite nga momenti i kur ngjitet tuberkulozi derisa vjen smundja. Jo të gjithë e zhvillojn smundjen.

Me rastin e smundjes simptomat paraqiten nga ato organe të trupit që janë smur. Simptomat e zakonshme të tuberkulozit të mushkrive janë koltje afatgjate, temperatur, djersitje e natës dhe humbja e peshës.

Sherimi i tuberkulozit Tuberkulozi sherohet zakonisht me tableta për gjashë muaj. Për tu shëruar është e rëndësisë së madhe që sherimi të bëhet në menyre të drejtë. Gjithë sherimi i tuberkulozit në Norvegji i nënshtrohet observimit të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se personeli mjekësor kujdest që pacienti ti zbatoj udhëzimet e sherimit ashtu siq ka vendosur mjeku.

Disave u ofrohet sherimi para se të kanë zhvilluar smundjen. Kjo posaqërisht vlen për fëmijet e vegjel, të cilët më lehtë mund të zhvillojn formë serioze të tuberkulozit.

Kontrollimi i detyruar i tuberkulozit

Grupet e caktuara janë të detyruar të bëjnë kontrollin për tuberkuloz. Kjo vlen posaqërisht për personat që vijnë nga vendet ku tuberkulozi është i zakonshëm, dhe që do qëndrojnë më shumë se tre muaj në Norvegji. Kontrolli nënkupton një test gërvishitje lëkure dhe një provë gjaku, si dhe radiografi e mushkërive për personat mbi 15 vjec.

Qëllimi i kontrollit është:

- ta zbuloj sa më heret smundjen të ofroj sherim dhe të pengoj përhapjen
- të gjej personat që janë me tuberkuloz, pa qen të smuar për bër sherim parandalus
- të ofroj vaksinim kundër tuberkulozit (BCG) përonave të cilët nuk u është ngjitur dhe të cilët nuk janë të vaksinuar

Është me rëndësi që edhe personat pa leje qëndrimi në Norvegji të kontrollohen për tuberkuloz. Në rast se konkludohet se ka tuberkuloz kjo nuk do të ndikoj negativisht në kërkesen për leje qëndrimi.

Smundja mund të zhvillohet pas shumë vitesh pasi të jet ngjitur. Mund dhe të ngjitet pas qëndrimit të gjatë në një vend ku tuberkulozi është i zakonshëm. Me rastin e paraqitjes së simptomave të tuberkulozit duhet kontaktuar mjeku sa më parë. Në rast se ke nevojë për më shumë informata për tuberkuloz apo dëshiron të kontrollohesh, mund të kontaktoni me mjekun tuaj të përhershëm, mjekun komunal apo shtepin më të afërt të shëndetit.